



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

RREGULLORE

MBI

**“PËRCAKTIMIN E MASAVE MBROJTËSE TË JASHTËZAKONSHME PËR
KUFIZIMIN E PËRHAPJES SË COVID-19, GJATË USHTRIMIT TË
VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË KOMISIONERËVE PUBLIKË”**

Miratuar me vendimin nr. 6, datë 8.5.2020, të Mbledhjes së Komisionerëve Publikë

Kreu I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në nenin 69, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 42 të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen sociale”, në nenin 4 të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive”, në nenin 7, pika 2, germa “dh”, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 156, datë 10.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, si edhe udhëzues të tjerë të Ministrisë së Shëndetësisë në këtë drejtim.

Neni 2

Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i masave mbrojtëse të jashtëzakonshme organizative e administrative dhe i rregullave e praktikave të duhura për kufizimin e përhapjes së COVID-19, gjatë ushtrimit në vijim të veprimtarisë së Institucionit të Komisionerëve Publikë.

Neni 3

Qëllimi i rregullores

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të garantojë:

1. Minimizimin e transmetimit të infeksionit midis punonjësve të IKP-së.
2. Sigurimin e një ambienti të shëndetshëm në punë.
3. Vijueshmërinë e aktivitetit të IKP-së.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- 1. IKP** është Institucioni i Komisionerëve Publikë.

2. **Punonjësi** është çdo pjesëtar i Njesisë Ligjore dhe i Njesisë Administrative të IKP-së.
3. **Struktura përgjegjëse** është Kancelari dhe dy Drejtorët e Drejtorive: Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.
4. **Mjete të mbrojtjes personale** janë maskat dhe dorezat.
5. **Dezinfektim** nënkupton një procedurë, thelbin e së cilës e përbën ndërmarrja e masave shëndetësore për të kontrolluar ose vrarë agjentët infeksiozë, që janë të pranishëm në mjete apo pajisje pune dhe dërgesa postare, nëpërmjet ekspozimit të drejtpërdrejtë të tyre ndaj agjentëve kimikë ose fizikë.
6. **COVID-19** (shkurtim i “Sëmundja koronavirus 2019”) është një sëmundje infektive e shkaktuar nga sindromi i rëndë akut i frymëmarrjes koronavirus 2 (SARS-CoV-2).
7. **127** është numri telefonik i Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore.
8. **ISHP** është Instituti i Shëndetit Publik.
9. **NJVKSH** është Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor në Qarkun e Tiranës.

Kreu II

MASAT E PËRGJITHSHME DHE DETYRIMET PËR ZBATIMIN E TYRE

Neni 5

Masa të përgjithshme organizative

1. Në Institucionin e Komisionerëve Publikë ngrihet Struktura Përgjegjëse për koordinimin e masave për zbatimin e kësaj rregulloreje, e cila drejtohet nga Kancelari dhe ka në përberjen e saj dy Drejtorët e Drejtorive: Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.
2. Puna në Institucionin e Komisionerëve Publikë, gjatë kohëzgjatjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, do të organizohet duke vlerësuar mundësinë e koordinimit të punës në zyrë me atë në distancë, në varësi të natyrës së detyrave dhe funksioneve, me qëllim që të sigurohet distancimi i nevojshëm fizik në ambientet e institucionit, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë.
3. Për këtë do të përcaktohet në mënyrë të detajuar një grafik i punonjësve që do të punojnë në ambientet e institucionit dhe të atyre që do të punojnë në distancë *online*, i cili do të miratohet nga titullarët e Institucionit.
4. Puna në distancë *online* ka të njëjtën kohëzgjatje kohore, si edhe puna në ambientet e institucionit dhe punonjësit duhet të jenë të aksesueshëm nga eprori direkt gjatë gjithë kohëzgjatjes së orarit zyrtar.

5. Për të bërë të mundur shmangien e kontakteve të afërta fizike gjatë procesit të punës në institucion, do të mundësohet krijimi i barrierave fizike apo komunikimet në distancë (telefon, *email*). Për punën në distancë *online*, *email*-i zyrtar mund të konfigurohet për t'u përdorur në telefon ose edhe në *web* nëpërmjet linkut <https://owa.e-albania.al/owa>, me asistencën e Specialistit IT të institucionit.

6. Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, nëpërmjet strukturës IT, asiston punonjësit që punojnë *online* për funksionimin e *email*-it zyrtar, aplikacioneve dhe metodave të ndryshme për komunikimin dhe takimet *online*.

7. Shërbimi i pritjes me popullin do të vijojë *online*, si dhe nëpërmjet shërbimit postar. Qytetarët duhet t'i dërgojnë denoncimet e tyre nëpërmjet postës elektronike, në adresën: info@ikp.al; regjistrimit të denoncimit në faqen zyrtare në rubrikën e dedikuar: "DENONCO", në linkun: <http://ikp.al/denonco/>; nëpërmjet postës zyrtare në adresën: Institucioni i Komisionerëve Publikë, bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 8, Tiranë.

8. Në ambientet e institucionit, në vende të dukshme, vendosen postera që pasqyrojnë qartë rregullat dhe masat e duhura për higjienën, për inkurajimin e personelit për zbatimin e tyre.

9. Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve publikon në faqen zyrtare këtë rregullore, njoftimet e nevojshme mbi vijueshmërinë e aktivitetit të IKP-së, si edhe njoftime për mënyrën e ofrimit të shërbimit ndaj publikut. Të gjitha këto njoftime do të afishohen edhe në hyrje të institucionit, në Këndin e Njoftimeve.

Neni 6

Masa të përgjithshme higjieno-sanitare

1. Në ambientet e IKP-së duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme përdorimi i produkteve të higjienës, ku përfshihen: detergjentë, dezinfektantët me bazë alkooli, që kanë të paktën 60% alkool, letër të pastrimit të duarve, letra dhe dezinfektantë për pastrimin e sipërfaqeve.

2. Punonjësve iu sigurohet në mënyrë të vazhdueshme pajisja me mjetet mbrojtëse personale. Maskat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si edhe prej material pëlhure (sipas udhëzimeve të MSH-së), në analizë të burimeve buxhetore në dispozicion, si edhe në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, për përdorimin me efektivitet dhe eficiencë të fondeve buxhetore të miratuara me ligj.

3. Në vendin e punës duhet të praktikohet dezinfektim dhe pastrim i vazhdueshëm i sipërfaqeve dhe i elementeve të tjera të vendit të punës, si për shembull: tryezat e punës, tastierat, telefonat dhe dorezat e dyerve. Produktet dezinfektante që përdoren për pastrim duhet të kenë përqindjen e alkoolit sipas pikës 1 të këtij neni dhe metodën e duhur të përdorimit.

4. Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse kontrollon dhe siguron, për aq sa është e mundur, mbajtjen në funksion normal të të gjitha pajisjeve të ventilimit të ajrit, me qëllim rritjen e niveleve të ventilimit dhe të përqindjes së ajrit që qarkullon në sistem.

5. Punonjëset e pastrimit duhet t'i pastrojnë 3 (tri) herë në ditë ambientet e institucionit dhe çdo 30 minuta të pastrojnë dhe të dezinfektojnë tualetet dhe dorezat e dyerve të çdo zyre, si dhe objektet në përdorim të përbashkët.

Neni 7

Detyrimet e Strukturës Përgjegjëse

1. Struktura përgjegjëse duhet të sigurojë marrjen e të gjitha masave paraprake të parashikuara në nenin 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje dhe të hartojë një plan masash në zbatim të saj.

2. Struktura Përgjegjëse duhet të orientojë, të këshillojë, të nxisë, të rekomandojë të gjithë personelin për njohjen dhe zbatimin e masave të parashikuara në këtë rregullore, sipas udhëzuesve të autoriteteve shëndetësore, të cilat duhet t'i ndjekë në vazhdimësi.

3. Struktura Përgjegjëse monitoron rregullisht zbatimin e masave të përcaktuara të higjienës dhe të kujdesit.

4. Struktura përgjegjëse siguron kushtet dhe mjetet për matjen e temperaturës në hyrje të institucionit për çdo punonjës apo vizitor, dhe nuk lejon hyrjen e tyre në institucion pa maskë.

5. Struktura përgjegjëse largon menjëherë punonjësën nga puna për të qëndruar në shtëpi, nëse ai shfaq shenja klinike të dukshme të COVID-19.

6. Struktura Përgjegjëse siguron një listë paraprake me numrat e kontaktit të NJVKSH-ve të qytetit të Tiranës dhe të ISHP-së.

7. Me rregulloren e miratuar mbi tërësinë e masave për minimizimin e transmetimit të infeksionit COVID-19 duhet të njihen të gjithë punonjësit e IKP-së.

Neni 8

Detyrimet e punonjësit

1. Punonjësi nuk duhet të përdorë telefonat, tavolinat, zyrat ose mjetet dhe pajisjet e punonjësve të tjerë, kur është e mundur. Nëse është e nevojshme, ato duhet të pastrohen ose dezinfektohen para dhe pas përdorimit.

2. Punonjësit duhet të përdorin gjatë orarit të punës mjete të mbrojtjes personale. Punonjësit që kanë kontakte me publikun dhe shërbimin postar duhet të përdorin detyrimisht gjatë kontaktit me ta mjetet e mbrojtjes personale (maska edhe doreza), të cilat duhet të ndërrohen në momentin e hyrje-daljes në ambientet e IKP-së.

3. Punonjësit duhet të lajnë shpesh duart dhe të përdorin dezinfektantët që ndodhen në ambientet e institucionit. (Mbështetur në udhëzuesin e MSHMS-së mbi hapat dhe mënyrën e larjes së duarve.)
4. Punonjësit nuk duhet të përdorin shtrëngimin e duarve, por metoda të tjera jokontaktuese të përshëndetjes.
5. Punonjësit duhet të respektojnë masat e distancimit fizik e social sipas rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë në ambientet e Institucionit dhe jashtë tij, për të mbrojtur shëndetin e tyre, të afërmëve dhe kolegëve.
6. Punonjësit duhet të respektojnë praktikën e etikës respiratore, kollitjes e teshtitjes nëpërmjet vënies së gropëzës së bërrylit përpara gojës dhe hundës.
7. Punonjësi është i detyruar të qëndrojë në shtëpi, në vetëkarantinim, nëse ka pasur kontakt të ngushtë me një person të infektuar me COVID-19, dhe të njoftojë menjëherë strukturën përgjegjëse, e cila më pas njofton NJVKSH-në përkatëse dhe ISHP-në.
8. Punonjësi që ka shenja klinike, duhet të qëndrojë në shtëpi, të vetizohet dhe të monitorojë shenjat klinike dhe për çdo shqetësim të njoftojë numrin 127, mjekun e familjes, si dhe të njoftojë Strukturën Përgjegjëse.

Neni 9

Dispozitat e fundit

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë me miratimin nga Mbledhja e Komisionerëve Publikë dhe zbatohet nga të gjithë punonjësit dhe vizitorët në institucion.